



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2023:090761

Datë: 16.10.2024

Numri i dokumentit: 06306011

C.nr.126/23

Gjykata Themelore Gjakovë - Dega Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Nehat Qelaj, si dhe me Zyrtarin e Lartë për Bashkëpunim Profesional Visar Morina në çështjen juridike të paditësit L.Knga M. me vendbanim në F.K., të cilën me autorizim e përfaqëson Av. Agron Kryeziu nga Malisheva, ndaj të paditurës Komuna e Malishevës – Drejtoria e Arsimit, të cilën me autorizim e përfaqëson avokati publik komunal Mujë Sahitaj, sipas bazës juridike kompensim i shpenzimeve të udhëtimit, jashtë seancës gjyqësore, me datën 16.10.2024 muar këtë:

A K T G J Y K I M
PA SHQYRTIM KRYESOR TË ÇËSHTJES

I. APROVOHET pjesërishtë si e bazuar kërkesëpadia e paditeses L.Knga M. me vendbanim në F.K..

II. DETYROHET e paditura Komuna e Malishevës – Drejtoria e Arsimit, t`ia paguaj paditësit L.Knë emër të shpenzimeve të udhëtimit për periudhën nga data 2020-2022 për 420 ditë të përlogaritur nga 3.50 euro në çdo ditë pune në 70% të biletës t`ia paguaj shumën prej **1,470.00 euro**, të gjitha këto në afatin prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

III. REFUZOHET si e pa bazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë e kërkuar në emër shpenzimeve të udhëtimit për periudhën e vitit 2017-2019 për 374 ditë pune.

IV. DETYROHET e paditura që paditëses t`ia kompensojë shpenzimet e procedurës paditëseve dhe atë në emër të parashtrimit të padisë në shumën prej 104.00 euro dhe në emër të taksës gjyqësore shumën prej 21.00 euro.

A r s y e t i m

Paditësja L.Knga M. me vendbanim në F.K., përmes të autorizuarit të saj Av. Agron Kryeziu nga Malisheva, në këtë gjykate ka parashtruar padi ndaj të paditurës Komuna e Malishevës – Drejtoria e Arsimit, sipas bazës juridike kompensim i shpenzimeve të udhëtimit, sipas padisë mësimdhënësja është e punësuar në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët “Dëshmorët

e Fshatit B.” në fshatin B. Komuna e Malishevës, duke kërkuar nga gjykata ta njeh dhe ta realizon këtë të drejtë, gjykatës i ka propozuar që të aprovojë në tërësi padinë dhe kërkespadinë e paditëses si të bazuar, duke e detyruar të paditurën që paditëses ti kompenzojë për periudhën për vitin 18.04.2017 deri më datë 18.11.2022, për 794 ditë x 3.50 = 2,779.00 euro.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë për përpilimin e padisë shumë prej 104.00 euro dhe për taksë gjyqësore shumë prej 21 euro.

Gjykata pas shqyrtimit paraprak të padisë së paditësit e ka njoftuar të paditurën me aktvendim mbi dhënien e përgjigjes në padi.

E paditura përmes përgjigjes së saj në padi ndër të tjera ka theksuar se e njoftojmë Gjykatën se ne kemi marrë të gjitha shkresat e lëndës për këtë çështje kontestimore, por kërkesa e parashtruar nga paditësi në këtë rast e lidhur më pagesën e udhëtimit sipas kontratës kolektive nenin 35 të kjo padi është ne kundërshtim kontratën kolektive për faktin se paditësi nuk ka ofruar prova se nga cili relacion udhëtojnë dhe ne qfar kohe por ka ofruar dy bileta të autobusit për gjithë paditësit , ndërsa kontrata kolektive sipas nenit 35 pika 5 thotë se gjithë punëtorët e arsimit që udhëtojnë në vendbanimet përkatëse të komunës duhet tu paguhet 70% të biletave të udhëtimit gjë që në këtë rast paditësit nuk ka ofruar bileta , pra nuk ka ofruar prova dhe kuponet fiskal për gjithë vitet kalendarike në mënyrë që të jetë bindëse në kërkesën e tij. Pra nuk ka ofruar argumente dhe prova gjithë kuponët fiskal të biletave udhëtimit kohen kur paditësi ka udhëtuar për në punë e jo vetëm të ofrohet kupona blanko dhe në bazë të supozimeve, Komuna e Malishevës e konteston vlerën e borgjit lidhur më këtë çështje, pasi që kontrata kolektive e arsimit e lidhur në mes të SBASHK dhe MASHT është shkeputur nga MASHT dhe kjo kontratë kolektive tani nuk është në fuqi, pasi që palet të cilet e kanë nënshkruar këtë kontratë nuk kanë pasur legjitimitet që ta nashkruajnë këtë kontratë dhe i ka munguar baza ligjore për nënshkrimin e saj ,e gjitha kjo bazuar në njoftimin që ka bërë MASHT për SBASHK më dt: 21.11.2022 për shkputjen e kësaj kontrate, poashtu, MAPL ka bërë njoftim për krytarët e komunave më dt: 22.11.2022 për shkputjen e kësaj kontrate nga MASHT për munges të bazës ligjore të kesaj kontrate kolektive, lidhur më pagesën e kualifikimit nuk ka asnjë bazë ligjore në kontratën kolektive, për faktin që bazë të kontratës së mësimdhënseve kualifikimi i paguhet për qdo mësuesdhënës që është paraqitur në kontratën e punës gradim mbi pagën bazë, poashtu edhe po që se në këtë rast do të kishte kjo padi bazë ligjore në bazë të kontratës kolektive të arsimit vitit 2017, kemi të bëjmë më parashkrim në baz të nenit 352 dhe neni 353 pika 1 e LMD —së dhe kjo kërkesë padi është e pasafatshme pasi që është paraqitur më dt:17.06.2022 pesë vite më vonë pasi ka hyrë kontratat kolektive e vitit 2017 në fuqi pasi kjo kontratë ka skaduar më dt:18.04.2020, gjykatës i ka propozuar që padinë e paditësit ta refuzoj si të pa bazuar..

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata i shqyrtoi këto provave dhe atë: Vërtetimin mbi përvojën e punës nr.101/2023 të datës 26.01.2023 dhe Kuponin të lëshuar nga NT “Berdyna” lidhur me relacionet e udhëtimit dhe çmimin e tyre.

Pas vlerësimit të të gjitha provave veç dhe veç dhe në lidhmëni me njëra tjetrën, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, gjykata vlerëson se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar, ndërsa e aprovoj pjesërishtë për nga lartësia.

Në bazë të provave të sipërpërmendura dhe përgjigjes së dhënë në padi nga e paditura, gjykata vlerëson se nuk është kontestuese se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura ndërsa kontestuese rezulton të jetë drejta e kompensimit të mjeteve në emër shpenzimeve të udhëtimit, për periudhën përkatësisht ditët si në dispozitiv këtij Aktgjykimi, gjë për cilën e paditura e ka pohuar këtë të drejtë të tyre, andaj nga provat e administruara, si dhe konform dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 dhe Kontratës Kolektive të datës 22.01.2021 e lidhur në mes Ministrisë së Arsimit Shkencë dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës dhe SBASHK, sipas neni 35 par. 5 në të cilën përcaktohet se **“Punonjësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimin e komunës përkatëse ku punojnë i paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut rrugor”** kjo gjykatë vlerëson se paditëses i takon e drejta e kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit gjykata u bazua në biletat e udhëtimit – kuponët fiskal me anë të të cilave vërtetohet se paditësj kanë udhëtuar nga vendbanimet e saj në vendin e punës.

Sipas nenit 8 parag.1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimeve **“Pjesëmarrësit në raportet e detyrimeve janë të detyruar që ti përmbushin detyrimet e tyre dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tyre”** ndërsa në dispozitat e nenit 245 par.1 të LMD-së, ka paraparë se **“Kreditori në marrëveshjet detyrimeve është i autorizuar që nga debitori të kërkojë përmbushjen e detyrimit e debitori është i detyruar ta përmbush me ndërgjegje këtë në tërësi ashtu si është e paraparë”**, ndërsa në Ligjin e Punës Nr.03/L-212 Gazeta Zyrtare Nr. 90 / 01 Dhjetor 2010 në dispozitat e nenit 90 par.5 lidhur me Marrëveshjen Kolektive përcaktohet se **“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”**, meqenëse në rastin konkret është vërtetuar se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura lidhur me kërkesën për kompensimin në emër të shpenzimeve të udhëtimit u vendos që të njëjtën t’u aprovojë sipas periudhës për vitin 2019 -2022 gjatë të cilës paditësja ka punuar tek e paditura fakt ky që u vërtetua edhe nga vërtetimet e lartcekura, në këtë gjendje të vërtetuar faktike e detyroj të paditurën që paditëses t’ia paguaj shumat si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata shqyrtoi edhe pretendimet e të paditurës lidhur me parashkrimin e kërkesës së paditësve, por gjykata pretendimet e e tilla i konsideroi pjesërishtë të bazuara, përkatësisht gjykata vlerëson se kërkesa e paditësit për periudhën për vitin 2017 dhe periudhën e vitit 2019 është e parashkruar, ngase në vështrim të shkresave të lëndës, konstatohet se paditësit padinë e kanë parashtruar në vitin 2023, ndërsa kërkesa e padisë rezulton e kërkuar nga viti 2017 ndërsa sa i përket kërkesave pas vitit 2018 për gjykatën padia rezulton e afatshme e që për rrjedhojë në rastin konkret nuk ka parashkrim të kërkesës, dhe nga kjo gjendje faktike ndërlidhur me dispozitat e Ligjit të Punës Nr.03/L-212, sa i përket kërkesave neni 87 lidhur me afatin e parashkrimit përcaktohen se **“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”**, ndërsa pretendimet e të autorizuarit të të paditurës lidhur me legjitimitetin e saj në procedurë, gjykata

pretendimet e tilla i konsideroi të pa bazuara ngase e paditura lidhur me kompensimin e shujtave ditore obligohet në bazë të detyrimeve të cilat dalin nga Kontrata Kolektive, nënshkruese e të cilës është Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, përkatësisht në nenin 2 par.1.1 të kësaj kontrate lidhur me zbatimin e këtyre dispozitave përcaktohet se **“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive, janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit Parauniversitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ultë dhe të mesëm të lartë, shkolla special e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut”**, ndërsa dispozitat e par.1.2 përcaktohet se **“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat-DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës”**, ndërsa sa i përket pretendimeve për shkëputjen e kontratës kolektive, për gjykatën po ashtu të njëjtat janë të pa bazuara, ngase paditësit sipas padisë kërkojnë realizimin e të drejtave gjatë periudhës në të cilën ishte në fuqi Kontrata Kolektive, për çka edhe rrjedhimisht derivojnë të drejtat nga akti juridik i tillë.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori konform nenit 452.1 të LPK-së, dhe Rregullores për tarifat e Avokatëve, duke detyruar të paditurën që paditësit t’ia paguajë dhe atë në emër të parashtrimit të padisë në shumën prej 104.00 euro dhe në emër të taksës gjyqësore shumën prej 21.00 euro.

Me sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në bazë të nenit 152 , dhe 398 të LPK-së si dhe nenit 90 parg.5 të Ligjit të Punës lidhur me 35.7 e Kontratës Kolektive Arsimit.

**Gjykata Themelore në Gjakovë-Dega në Malishevë
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil
C.nr.126/23 me datën 16.10.2024**

**G j y q t a r i
Nehat Qelaj**

Udhëzim juridik: Kundër këtij aktgjykimi, palët kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej 7 ditësh pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës, ankesa dërgohet përmes kësaj gjykate.